



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:174317

Datë: 21.04.2021

Numri i dokumentit: 01717446

**PKR.NR.283/20**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA**, me gjyqtaren Violeta Husaj-Rugova me pjesëmarrjen e praktikantes gjyqësore Dafina Gashi si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit Q. S. nga K. .... me banim në fsh. ...., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti për Krime të Rënda, PP/I.nr.262/20 të dt.16.12.2020, pas mbajtjes së seancës për shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, në prezencë të Prokurorit të shtetit Valbona Disha Haxhosaj, të akuzuarit Q. S. , me dt. 15.04.2020 mori, dhe me dt.21.04.2021 e përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari**

**Q. S.** , i biri i A. dhe nenës L. e gjinisë G., i lindur me dt. .... në ....., ndërsa tani me vendbanim në fshatin ..... K- ....., i pa martuar, ka të kryer shkollën mesme, pa punë, posedon nr. tel ....., i gjendjes së dobët ekonomike, nr. personal ....., shqiptar, Shtetas i R. së Kosovës.

**ËSHTË FAJTOR**

Për shkak se:

Më parë e gjerë me dt. 23.11.2020, rreth orës 21:55, në fsh. .... K....., i pandehuri në kundërshtim me nenin 5 par. 1 të Ligjit për Armë (Ligji Nr. 05/L-022), ka mbajtur në pronësi dhe kontroll dhe atë : një Sprej me mbishkrimin “Nato”, në atë mënyre që në natën kritike pasi që Policia e Kosovës kanë marrë informatë se në vendin e lartcekur janë mbledhur disa persona duke konsumuar pije alkoolike duke mos e respektuar kufizimin e orarit të lëvizjes gjatë pandemisë Covid-19, policia kanë shkruar në vendin e ngjarje dhe kanë kontrolluar gjithë personat qe kanë qenë prezent dhe tek i pandehuri Q. S. Policia kanë gjetur dhe konfiskuar sprejin me të dhënat e lartcekur,

-Me çka ka kryer veprë penale, mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së

Andaj , gjykata konform nenit 7,21, 38,40 par.1 nën par. 1.3, 43,69,70 dhe nenit 366 par.1 të KP të Kosovës, 233, 365 të KPP të Kosovës, të akuzuarit i shqipton :

### **DËNIM ME GJOBË**

Të akuzuarit i cakton dënim me gjobë në lartësi prej 200€ (dyqind euro), të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 3(tre)muajsh, nga data e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse i pandehuri i lartcekur dënimin nuk e paguan në afat të caktuar ,atëherë dënimin me gjobë gjykata do ta zëvendësoi me dënim burgu, duke llogaritur një ditë burgim për çdo 20 (njëzet) euro të gjobës.

I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 15€ (pesëmbëdhjetë euro), si dhe shumën 50€ (pesëdhjetë euro) në emër të viktimave, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë ) ditësh, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

Të akuzuarit i konfiskohet një Sprej me mbishkrimin “Nato”, dhe pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi i njëjti do të asgjësohet, që gjendet në ruajtje sipas rastit policorë 2020-DA-1745.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti për Krime të Rënda, ka ngrit aktakuzë PP/I.nr.262/20 të dt.16.12.2020,, kundër të akuzuarit Q. S. nga fsh. .... K-....., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka mbajtur seancën për shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë me dt.15.04.2021, në seancën për shqyrtimin e marrëveshjes janë prezantuar prokurori i shtetit Valbona Disha Haxhosaj, i akuzuari Q. S. dhe mbrojtësi i tij av.T. Rr. ku është bërë e ditur përkatësisht është konfirmuar se: i pandehuri, mbrojtësi i tij dhe prokurori i shtetit me dt. 10.12.2020 kanë lidhë marrëveshje për pranimin e fajësisë dhe të njëjtën marrëveshje sërish e kanë konfirmuar edhe në shqyrtimin gjyqësor, dhe këtë marrëveshje gjyqtarja e ka pranuar – e bindur thellë se marrëveshja e tillë është bërë konform dispozitës së nenit 233 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës .

Pasi që u aprovua përkatësisht u pranua marrëveshja mbi pranimin e fajësisë gjyqtarja e konfirmoj edhe vendimin mbi dënimin ashtu siç është arritur edhe në marrëveshjen për pranimin e fajësisë. Bazuar në gjendjen e dobët ekonomike të akuzuarit caktoj dënimin në minimumin e paraparë në marrëveshje si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konfrom nenit 450 të akuzuarin e obligon në paguarjen e shpenzimeve procedurale.

Konform nenit 39 par.1,2,3 nen par.3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit e obligoj me pagesën në shumën si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Konform neni 366 par.3 të KPRK-së i konfiskoj sprejin e cekur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPPK-së.

**GJYKATA THEMELORE PEJË  
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA,**

**2020:174317, 21.04.2021**

**Kryetarja e trupit gjykues**

---

Violeta Husaj Rugova

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.